



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.66 dt.15.05.1997

PER

**MIRATIMIN E PLANIT TE TE ARDHURAVE PER VITIN 1997 DHE TE
PLANIT PROVIZOR TE SHPENZIMEVE PER KATERMUJORIN 1997,
SIPAS FONDIT TE MIRATUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE PER
KETE PERIUDHE DERI NE MIRATIMIN E BUXHETIT PER VITIN 1997**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.15.05.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës, mbështetur në Ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, Ligjin Nr.7616, dt.30.09.1992 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin Nr.7777, dt.22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.7582, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë”, të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre,

VENDOSI

1. Të miratojë realizimin e planit të të ardhurave për vitin 1996 nga burime të veta tatimore e jotatimore të Bashkisë Tiranë në shumën 265.839.398 lekë sipas pasqyrës Nr.1 bashkangjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë realizimin e shpenzimeve nga Bashkia e Tiranës për vitin 1996 për shumën 258.899.696 lekë, sipas pasqyrës Nr.1/1 dhe aneksit të saj bashkangjitur këtij vendimi.
3. Të miratojë planin e të ardhurave nga burimet e veta të Bashkisë Tiranë për shumën 286.248.000 lekë, sipas pasqyrës Nr.2 bashkangjitur.
4. Të miratojë planin provizor të shpenzimeve për katërmujorin e parë të vitit 1997 nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë për shumën 50.000.000 lekë, sipas miratimit të bërë nga Ministria e Financave, sipas pasqyrës Nr.5 bashkangjitur këtij vendimi. Diferencat e papërdorura të krijuara gjatë katërmujorit të parë 1997 të përdoren për financimin e shpenzimeve më të domosdoshme për muajin maj, sipas miratimit që do të bëhet nga Këshilli i Bashkisë, deri në miratimin e planit të Buxhetit për vitin 1997 dhe

kalimin e tij në këtë këshill për miratimin e planit të buxhetit dhe shpenzimeve për vitin 1997, brenda të cilit do të përfshihet edhe plani provizor i miratuar nga Këshilli i Bashkisë.

5. Me ardhjen e planit të Buxhetit për vitin 1997, Drejtoria e Financës në Bashki të përgatisë menjëherë materialin përfundimtar për miratimin e realizimit të planit të Buxhetit për vitin 1996, miratimin e planit të buxhetit dhe shpenzimeve për vitin 1997, i cili do t'i bashkangjitet këtij vendimi.
6. Ngarkohen Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI